



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURES  
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 862 Prot.

Tiranë, më 06 . 07 2018

**VENDIM Nr. 139, datë 27.06.2018**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.6, datë 27.06.2018, pasi shqyrtoi *Projektin kërkimor shkencor "Projekti shqiptaro-francez i pellgut të Korçës" 2018-2020* miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Akademia e Studimeve Albanologjike), drejtues Dr. Rovena Kurti, Departamenti i Prehistorisë/Institutit i Arkeologjisë dhe Dr. Cecile Oberweiler, Maison de l'Archéologie et de l'Ethnologie R. Ginouvés, Universiteti i Nanterre/Paris, paraqitur nga Institutit i Arkeologjisë,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë *Projektin kërkimor shkencor "Projekti shqiptaro-francez i pellgut të Korçës" 2018-2020* miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Akademia e Studimeve Albanologjike), drejtues Dr. Rovena Kurti, Departamenti i Prehistorisë/Institutit i Arkeologjisë dhe Dr. Cecile Oberweiler, Maison de l'Archéologie et de l'Ethnologie R. Ginouvés, Universiteti i Nanterre/Paris, paraqitur nga Institutit i Arkeologjisë, në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:
  - Vëzhgime sipërfaqësore (Survej) në disa prej siteve të fortifikuara prehistorike të pellgut të Korçës: Blacë, Boboshticë, Dishnicë, Gjonomadh, Gradishta e Symizës, Hija e Korbit, Kakaç, Kuç i Zi, Leshnjë, Lumalas, Mborje, Podgori, Vithkuq dhe Zvezdë.
  - Inspektime gjeofizike në tumat e fshatit Sovjan dhe Boboshticë.
2. Periudha kohore e kryerjes së punimeve do të jetë ajo e nevojshme për kryerjen e tyre, brenda vitit 2018.

3. Në rastet kur parashikohet ndërhyrje në sit/nëntokë dhe evidentohen struktura, duhet të përcaktohen masat që do të merren për konservimin/restaurimin/translokimin e tyre. Gjithashtu, në çdo rast, duhen përcaktuar masat për rehabilitimin e zonës.
4. Të depozitohet pranë ASHA dhe DRKK lista e gjetjeve me qëllim grumbullimin dhe ekspozimin e tyre në Muze.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR

MIRELA KLASHI/FURXHI

MINISTRE



SEKRETARI KKA

RUDINA ZOTO